



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0104

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga, Isa Hasani-Kryetar, Vjosa Gradinaj-Mexhuani- Anëtare dhe Vedat Poterqoi-Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) N.N.P "Euro Construction", kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Komunës së Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i objektit të Arhives së Komunës me infrastrukture përcjellëse” me numër të prokurimit; 616-23-12502-5-2-1, me 30/05/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE N.N.P "Euro Construction" me nr. 2024/0104, e datës 06/02/2024, kurse vendimi i AK- Komuna e Prishtinës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i objektit të Arhives së Komunës me infrastrukture përcjellëse” me numër të prokurimit 616-23-12502-5-2-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarrë lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Lejohet kthimi i tarifës për ankesë, në vlerën e deponuar për paraqitjen e ankesës, Operatorit ekonomik N.N.P. "Euro Construction", sipas nenit 31.4. OE obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për tërheqje të depozitës për sigurim të ankesës, në të kundërtën bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me datën: 09.11.2023, Komuna e Prishtinës, në cilësi të AK-së ka publikuar njoftimin për kontratë të aktivitetit të prokurimit: “Ndërtimi i objektit të Arhives së Komunës me infrastrukture

përcjellëse” me numër të prokurimit 616-23-12502-5-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: pune, furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 350,000.00 €.

Me 24.01.2024, AK ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës ku ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik “MBB Construction” & “Protec”SHPK.

Kundër vendimit të AK-së me datën 30.01.2024, OE N.N.P "Euro Construction" ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 31.01.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 06.02.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE N.N.P. "Euro Construction" me nr. 104/2024 lidhur me aktivitetin e cituar si në pikën I të dispozitivit.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

1. Pretendimet e operatorit ekonomik ankues N.N.P. "Euro Construction" ne ankesen 104/2024 janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I): OE ankues pretendon se gjate kërkesës për rishqyrtim herën e pare ne AK, kërkesa e tyre ishte miratuar si e bazuar dhe lënda ishte kthyer ne rivlerësim nga ana e AK ku me pas serish është shpallur fitues operatori i njëjtë "MBB Construction shpk & Protec shpk". “Arsyetimi i autoritetit kontraktues për eliminimin tonë, është i paqëndrueshëm dhe i pa bazuar, për faktin se ne e kemi prezantuar katalogun sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Kërkesa e dosjes së tenderit ka qenë shumë e qartë “OE duhet te ofroj katalogu qe përmbush specifikimin teknik” ndërsa dëshmia e kërkuar dokumentare ka qenë "Kopja e katalogut nga prodhuesi apo distributori Përderisa në dosje të tenderit nuk specifikohet që kompanitë duhet të prezantojnë edhe autorizimin nga prodhuesi në lidhje me katalogun, atëherë kuptohet qartë se autoriteti kontraktues na ka eliminuar në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së, pasi që jemi eliminuar për një kërkesë e cila nuk ka qenë e specifikuar në dosje të tenderit. Në dispozitën e lartcekur specifikohet qartë si në vijim: d. Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Duhet cekur fakti se ne në dosje të tenderit e kemi prezantuar edhe deklaratën për specifikime teknike, ku kemi deklaruar se produktet tona do të jenë në përputhje të plotë me specifikimet teknike. Andaj edhe nëse prodhuesit të cilit i përket katalogu i prezantuar nga ana jonë eventualisht nuk dëshiron të na i shes produktet, atëherë ne do ti sjellim produktet e njëjta sipas specifikimeve teknike nga një prodhues tjetër, mirëpo në asnjë mënyrë nuk mund dhe nuk është dashur të eliminohe mi nga ky aktivitet i prokurimit për një kërkesë e cilat nuk ka qenë e specifikuar në dosje të tenderit. Në këtë rast nuk qëndron asnjëri nga konstatimet e autoritetit kontraktues dhe sqarimi i anëtarit të grupit të OE të rekomanduar

për kontratë se kinse ne kemi bërë keqpërdorim të dokumenteve të ndonjë kompanie, për faktin se katalogjet e prodhuesit të cilat i kemi prezantuar në këtë aktivitet të prokurimit mund ti gjej secila kompani që dëshiron në web faqen e tij. Po ashtu të njëjtat dokumente nuk janë të mbrojtura dhe nuk figuron asnjë kod apo shënim që të njëjtat nuk guxojnë të përdoren, andaj në këtë rast nuk kemi të bëjmë fare me keqpërdorim pasi që katalogjet e të njëjtit mund të merren online në Eëbfaqen e tij, ndërsa nëse kompania në fjalë nuk dëshiron që të na shesë produktet atëherë përsëri jemi të zotuar se produktet do të ofrohen sipas specifikimit teknik dhe ne do ti ofrojmë. Duke u bazuar në faktet e lartcekura kuptohet qartë se deklarata e anëtarit të grupit të OE të rekomanduar për kontratë kinse për keqpërdorim të katalogjeve, është bërë me tendencë vetëm që ne si O.E i përgjegjshëm të mos rekomandohemi për kontratë, andaj e njëjta nuk është dashur të merret parasysh nga autoriteti kontraktues, ashtu siç nuk është marr parasysh edhe në vlerësimin e parë të cilin e ka bërë i njëjti autoritet kontraktues. Përveç shkeljeve ligjore që ka bërë autoriteti kontraktues me rastin e eliminimit tonë, sqarojmë se autoriteti kontraktues ka rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm për faktet si në vijim: Ne dosjen e tenderit tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale tek neni 9.1 .&0.2 i FDT-se përkatësisht tek kërkesa nr.3 është kërkuar: 3. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit. Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.

Pretendimi i dytë (II): OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar kërkesën e lartcekur për faktin se në ofertën e tij i njëjti ka prezantuar kamion me kran i cili nuk është sipas kërkesës së lartcekur të dosjes së tenderit, ku është specifikuar tek pika 1: kamion me kran dhe kiper. Faktin se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar kërkesën e lartcekur, e ka vërtetuar edhe vet autoriteti kontraktues në vendimin e saj për aprovimin e kërkesës tonë për rishqyrtim të dt.04.01.2024, ku i njëjti e kishte aprovuar si të bazuar pretendimin tonë ankimor sa i përket pajisjes së kontestuar më lartë nga ana jonë. Pra në momentin që është aprovuar kërkesa për rishqyrtim si e bazuar atëherë faktikisht është konstatuar se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, sepse ne kemi pasur vetëm këtë pretendim në kërkesë për rishqyrtim. Andaj duke u bazuar të gjitha faktet e lartcekura, vërtetohet se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe i tillë është dashur të konsiderohet edhe nga ana e autoritetit kontraktues dhe jo të rekomandohet për kontratë, pasi që me këtë veprim autoriteti kontraktues ka shfaqur haptas favorizimin që i ka bërë OE të rekomanduar për kontratë dhe diskriminimin që është bërë ndaj neve si OE i përgjegjshëm. Autoriteti kontraktues ka përdoruar standarde të dyfishta, pasi që fillimisht e ka pranuar si të bazuar pretendimin tonë në lidhje me papërgjegjshmërinë e OE të rekomanduar për kontratë, ndërsa pas rishqyrtimit përsëri e ka rekomanduar për kontratë. Gjithashtu OE Olti Trasing SH.P.K., i renditur me çmim më të lirë se ne është i papërgjegjshëm, ashtu siç e ka konstatuar edhe autoriteti kontraktues me arsyetimin si në vijim: Katalogu qe ju keni ofruar nuk përmbush kërkesat e specifikimit teknik nga AK. Ne Njoftimi për kontratë dhe ne Dosjen e Tenderit pika 9.1&9.2 ne piken 7 është kërkuar OE duhet te ofroj katalogun qe përmbush specifikimin teknik. Katalogu juaj i ofruar nuk përmbush specifikimin teknik i është kërkuar nga AK.

2. Përgjigje e AK-se ne kërkesën për rishqyrtim te OE N.N.P. "Euro Construction"& Tic Log SHPK & Sinani Ing SHPK

Autoriteti Kontraktues ka sqaruar: Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet cekur se përmes aneksit 7 të dosjes së tenderit është kërkuar ndër të tjera edhe një "Kamion me kran dhe kiper dhe peshë bartëse minimum 2 ton". Sa i përket pretendimeve ankimore kundër tenderuesit të rekomanduar është gjetur se me datë 10.01.2024 komisioni vlerësues ka kërkuar sqarime

shtesë pikërisht lidhur me përmbushjen e kërkesave sipas aneksit 7 të dosjes së tenderit. Me datë 12.01.2024 tenderuesi i rekomanduar ka dërguar sqarimet e kërkuara si në vijim: Në emër të "Protec" sh.p.k. me nr. biznesi 810045874, prodhues dhe montues i certifikuar i Sistemeve Modulare për Ruajtjen e Dokumenteve Arkivore deklarohet se, në aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i objektit të Arhives së Komunës me infrastrukture përcjellëse" me numër të prokurimit: 616-23-12502-5-2-1 me Autoritetin kontraktues "Komuna e Prishtinës" jemi duke marrë pjesë vetëm në Grupin e Operatorëve Ekonomik: MBB Construction dhe SH.P.K. dhe Protec SH.P.K. dhe se nuk jemi pjesë e asnjë grupi tjetër që merr pjesë në procedurë të njëjtë të prokurimit. Deklarohet se, asnjë Operator Ekonomik apo Grup i Operatoreve Ekonomik (përpos Grupit të Operatoreve Ekonomik: MBB Construction dhe SH.P.K. dhe PROTEC SH.P.K.) nuk është i Autorizuar ta dorëzojë katalogun e prodhimeve tona, në procedurën e prokurimit me titull: "Ndërtimi i objektit të Arhives së Komunës me infrastrukturë përcjellëse" me numër të prokurimit: 616-23-12502-5-2-1. Përdorimi i katalogut tonë nga cilido Operator Ekonomik apo Grup i Operatorëve Ekonomik, (pos Grupit të Operatorëve Ekonomik: MBB Construction dhe SH.P.K. dhe Protec SH.P.K.) në këtë aktivitet të prokurimit, është i pa autorizuar dhe është keqpërdorim. Duhet cekur poashtu se asnjë kompani apo individ, nuk është i autorizuar të bëjë montimin e Sistemeve Modulare për Ruajtjen e Dokumenteve Arkivore të prodhuara nga "Protec" SH.P.K përpos monterëve të certifikuar të kompanisë Protec SH.P.K.

Komisioni vlerësues i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga tenderuesi i rekomanduar. Duhet cekur se parashtruesi është eliminuar si tenderues i papërgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit për shkak të arsyeve të evidentuara në letrën standarde si vijon: Nuk keni ofruar katalogun e kërkuar sipas pikës 7 në kërkesat teknike dhe profesionale pika 9.1&9.2 Në Njoftimin për kontrate dhe në Dosjen e Tenderit pika 9.1&9.2 në pikën 7 është kërkuar: OE duhet të ofroj katalogun që përmbush specifikimin teknik dhe si dëshmi Kopja e Katalogut nga prodhuesi apo distributori.

Ju keni ofruar katalogun që është nga operatori Protec Shpk i cili operator është në marrëveshje bashkëpunimi me operatorin MBB Construction dhe i cili pas sqarimeve të kërkuara nga ana e AK është deklaruar se: Asnjë Operator Ekonomik apo grup i Operatoreve Ekonomik (përpos Grupit të Operatoreve Ekonomik: MBB Construction dhe Protec Shpk) nuk është i autorizuar ta dorëzojë katalogun e prodhimeve tona në procedurën e prokurimit me titull: ndërtimi i objektit të Arshivës së Komunës me infrastrukture përcjellëse me numër të prokurimit: 616 23 12502 521. Përdorimi i katalogut tonë nga cilido Operator Ekonomik apo grup i Operatoreve Ekonomik përpos grupit të operatoreve Ekonomik MBB Construction dhe Protec Shpk në këtë aktivitet të prokurimit është i paautorizuar dhe është keqpërdorim. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i parashtruesit është tërësisht i pabazuar. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtruesat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 14/02/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 104/2024, ndërsa me datë 27/02/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues dhe eksperti teknik me nr. 2024/104 me rekomandimet si në vijim: “Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim”.

3. Vlerësimi pretendimit ankimor OE N.N.P. "Euro Construction" eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/104 kanë vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I): Eksperti shqyrtues vlerëson se kjo çështje është trajtuar nga ana e AK gabimisht, në kontekstin e verifikimit të dokumentacionit dhe katalogut, një qasje që e vlerësoj si të duhur procedurale por jo në përputhje me kërkesat e DT, pasi në pikën 7 të dosjes kërkohet dëshmi përmes katalogut nga prodhuesi (Pika 7. Dëshmia: Kopja e katalogut nga prodhuesi apo distributori), dhe jo autorizim nga ana e prodhuesit apo distributorit, siç kërkohet zakonisht në këto raste. Pas analizimit të kësaj çështjeje në procedurat tjera vërehet se AK e ka praktikuar këtë kërkesë në procedurat e tjera tenderuese me specifikime adekuate, gjë që nuk është specifikuar apo kërkuar në këtë procedurë tenderuese. Kjo tregon se kemi të bëjmë me një kërkesë që mundë të sjellë huti si në rastin në fjalë dhe lejon çasje të dy anëshme, mirëpo jo të drejta nga AK në trajtimin e kësaj çështjeje. Për shkak të kërkesave të bëra në DT dhe mënyrës së trajtimit të çështjes nga ana e AK, duke mos e theksuar autorizimin si kryefjalë, siç theksohet edhe në përgjigjen e prodhuesit, i cili në këtë rast është edhe ofertues në këtë aktivitet të prokurimit, eksperti mendon se kjo është një çasje e gabuar dhe devijim i kërkesave të pozicionit 7 të DT. Prandaj, bazuar në sqarimet e dhëna më sipër, mendoj se pretendimi ankimor i OE ankues kundër vendimit të AK është i bazuar.

Konstatimi i dytë (II): Pas administrimit të dokumentacionit, kërkesave të DT Anekses 7 dhe vendimit të AK për rishqyrtim të ankesës së bërë nga ana e OE ankues lidhur me këtë çështje, eksperti shqyrtues vlerëson se në dokumentacionin e paraqitur në ofertën e OE së rekomanduar mungojnë dëshmitë se OE posedon këtë pajisje siç është kërkuar në pikën 1 të Anekses 7. Kjo argumentohet edhe në vendimin e AK të datës 04.01.2024 lidhur me këtë çështje, ku OE e rekomanduar nuk posedon këtë pajisje të tillë, por, megjithatë, AK ka vazhduar më tej në kundërshtim me LPP duke shpallur si fitues këtë OE. Prandaj, bazuar në sqarimet e dhëna më sipër, mendoj se pretendimi ankimor në këtë çështje kundër vendimit të AK është i bazuar.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët në procedurë, me c’rast Autoriteti Kontraktues nuk është pajtuar pjesërisht me mendimin e dhënë nga eksperti shqyrtues, ndërsa operatori ekonomik është pajtuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të

Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e raportit të ekspertit shqyrtues vlerësimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet si e bazuar ndërkaq vendimi i AK-së duhet të rivlerësohet, pasi që pretendimet e Ankuesit përbejnë bazë të mjaftueshme që aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Paneli shqyrtues konform raportit me rekomandime të ekspertit shqyrtues sqaron se AK gabimisht e ka trajtuar eliminimin e Ankuesit për pikën 7, pasi në pikën 7 të Dosjes tenderit kërkohet dëshmi përmes katalogut nga prodhuesi (Pika 7. Dëshmia: Kopja e katalogut nga prodhuesi apo distributori), dhe jo autorizim nga ana e prodhuesit apo distributorit, siç zakonisht kërkohet. AK e ka praktikuar këtë kërkesë në procedurat e tjera tenderuese me specifikime adekuate, gjë që nuk është specifikuar apo kërkuar në këtë procedurë tenderuese. Kjo tregon se kemi të bëjmë me një kërkesë që mundë të sjellë huti si në rastin në fjalë dhe lejon çasje të dy anëshme si në rastin konkret dhe paraqet devijim i kërkesave të pozicionit 7 të Dosjes tenderit.

Paneli shqyrtues lidhur me pretendimit e Ankuesit për mos plotësim të pikës 7 nga OE i rekomanduar vlerëson se në dokumentacionin e paraqitur në ofertën e OE së rekomanduar mungojnë dëshmitë se OE posedon pajisjen "Kamion me kran dhe kiper dhe peshë bartëse minimum 2 ton" siç është kërkuar në pikën 1 të Aneksit 7, andaj Paneli shqyrtues vlerëson se AK ka rekomanduar OE dhe shpallur fitues pa i plotsuar kërkesat e DT, dhe dispozitave ligjore të LPP-së.

Paneli shqyrtues perfundimisht ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i objektit të Arhives së Komunës me infrastrukture përcjellëse” me numër të prokurimit 616-23-12502-5-2-1, të anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim dhe AK të veprojë në raport me dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë dhe vlerësimeve të dala nga raporti i ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjellojë sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Krahas tjerash në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje lidhur me pohimet ankimore, prandaj Paneli shqyrtues mbështet vlerësimet dhe rekomandimin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar “Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj” lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themelojë një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës".

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të përsëritshëm të ankesës të OE N.N.P "Euro Construction", vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - N.N.P. "EURO CONSTRUCTION"**
- Arkivës së OSHP-së: